



KRYETARËT E KOMUNAVE PROTESTUAN KUNDËR QEVERISË, LV-ja DOLI KUNDËR I FAQE 4-5

- Kryetarët e komunave kanë kërkuar mbrojtjen e buxheteve dhe kompetencave lokale, ndërsa përfaqësuesit e LV-së e kanë kundërshtuar protestën, duke e cilësuar të motivuar politikisht



Kryetarët e disa komunave të Kosovës kanë protestuar para qeverisë, duke kërkuar mbrojtjen e buxheteve, pronës dhe kompetencave komunale si dhe

kompensimin e obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive. Protesta, e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, është mbështetur nga kryetarët e

komunave që drejtohen nga PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca, ndërsa është kundërshtuar nga kryetarët e LV-së të cilët e kanë cilësuar të motivuar politikisht

**HAMZA
PËR
SEJDIUN:
NUK E
VOTOJMË F. 3**



**KRYESIA
E LDK-së
MBËSHTET
MARRËVESHJEN
ME LV-NË PËR
PRESIDENTIN F. 4**



**BLOKADA NË KUVEND MUND
TA RREZIKOJË PRODHIMIN
E ENERGJISË NË KOSOVË F. 8**

SPORT



**SELMANI FITON MEDALJEN E ARTË,
E SHTATA PËR KOSOVËN NË
LOJËRAT MESDHETARE F. 11**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Keir Starmer jep dorëheqje edhe nga pozita e deputetit

LONDËR, 1 SHTATOR - Ish-kryeministri i Britanisë së Madhe, Sir Keir Starmer, ka njoftuar zyrtarisht për dorëheqjen nga mandati i deputetit i zonës Holborn dhe St Pancras, pas 11 vjetësh përfaqësim. Ky vendim do të

çojë në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në këtë zonë elektorale të Londrës, e cila konsiderohet një bastion i sigurt i Partisë Laburiste. Vendimi i Starmerit vjen si një ndryshim qëndrimi, pasi menjëherë pas dorëheqjes nga

pozita e kryeministrit më herët këtë verë, ku u zëvendësua nga Andy Burnham, ai kishte deklaruar se do të qëndronte në Parlament deri në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme. Për këtë arsye, kryetari i Partisë Konservatore, Kevin

Hollinrake, e ka kritikuar atë për një tjetër “kthesë 180-gradësh” që, sipas tij, u kushton taksapaguesve. Data e zgjedhjeve të reja në zonën elektorale do të përcaktohet sapo dorëheqja e tij të formalizohet zyrtarisht.



SHBA-ja MIRATON SHITJEN E MUNDSHME TË PAJISJEVE USHTARAKE PREJ 800 MILIONË DOLLARËSH PËR IRAKUN

UASHINGTON, 1 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara kanë miratuar një shitje të mundshme ushtarake prej 800 milionë dollarësh për Irakun, e cila përfshin helikopterë “Bell 412EPX” dhe “Bell 407M”, si dhe pajisje të lidhura me ta, ka njoftuar të hënën Departamenti Amerikan i Shtetit.

Paketa e propozuar përfshin helikopterë, mitralozë me tre tyta “GAU-19”, sisteme raketore, sensorë elektro-optikë/infrakuq, sisteme për zbulimin e lëshimit të raketave, radio, pjesë këmbimi dhe pajisje për mbështetje tokësore. Ajo përfshin gjithashtu trajnime për pilotët dhe mirëmbajtjen si dhe mbështetje

inxhinierike, teknike dhe logjistike nga qeveria amerikane dhe kontraktorët, sipas një deklarate të Departamentit të Shtetit.

Departamenti ka deklaruar se shitja e propozuar do ta mbështeste politikën e jashtme dhe interesat e sigurisë kombëtare të ShBA-së, duke forcuar kapacitetet e sigurisë së një partneri strategjik.

Sipas Departamentit, paketa synon ta rrisë aftësinë e Irakut për t’iu përgjigjur kërcënimeve aktuale dhe të ardhshme, veçanërisht përmes përmirësimit të kapaciteteve të transportit me helikopterë, zbulimit dhe goditjes së objektivave nga ajri në tokë.



DANIMARKA RIHAP AMBASADËN NË SIRI, PREMTON 76 MILIONË DOLLARË PËR RIMËKËMBJEN

DAMASK, 1 SHTATOR - Danimarka ka rihapur të hënën ambasadën në Damask, pas një mbylljeje 14-vjeçare, ndërsa ministri i Jashtëm, Lars Lokke Rasmussen, ka njoftuar ndarjen e 76 milionë dollarëve shtesë për ta mbështetur rimëkëmbjen dhe stabilitetin e Sirisë. Rasmussen ka marrë pjesë në ceremoninë e rihapjes së ambasadës së bashku me ministrin e Jashtëm sirian, Asaad al-Shaibani, sipas agjencisë zyrtare të lajmeve



SANA.

Al-Shaibani e ka cilësuar këtë lëvizje si një “kapitull i ri” në marrëdhëniet siriano-daneze dhe është shprehur se shpreson që ajo ta inkurajojë angazhimin dhe investimet më të mëdha evropiane në Siri. Rasmussen ka deklaruar se financimi do ta mbështesë rimëkëmbjen e hershme, stabilizimin dhe kthimin e refugjatëve. Ai ka shtuar se sirianët që kanë gjetur strehim në Danimarkë mund të kontribuojnë me aftësitë dhe

përvojën e tyre në rindërtimin e vendit, ndërsa kthehen në shtëpi. Rasmussen më vonë është takuar me presidentin sirian, Ahmed al-Sharaa, në Pallatin e Popullit në Damask. Presidenca siriane ka bërë me dije se bisedimet janë përqendruar në forcimin e lidhjeve dypalëshe dhe bashkëpunimin në rimëkëmbjen dhe rindërtimin e vendit si dhe në përpjekjet për ta mbështetur stabilitetin në Siri.

Rusia rikthehet në takimet e G20

VARSHAVË, 1 SHTATOR - Për herë të parë që nga pushtimi i Ukrainës në vitin 2022, ministri rus i Financave, Anton Siluanov, ka marrë pjesë fizikisht në një takim të G20-s. Prania e tij në tryezën e ministrave, në kohën kur Shtetet e Bashkuara mbajnë presidencën e grupit, ka shkaktuar pakënaqësi te disa përfaqësues evropianë. Ministri polak i Financave, Andrzej Domanski, ka deklaruar se Varshava nuk i beson Moskës dhe se çdo

komunikim me përfaqësuesit rusë duhet të bëhet me shumë kujdes. Edhe ministri gjerman i Financave, Lars Klingbeil, e ka cilësuar praninë e Siluanovit sinjal shqetësues për bashkëpunimin amerikan me Evropën lidhur me sanksionet ndaj Rusisë. Ndërkohë, Siluanov ka zhvilluar një takim dypalësh me sekretarin amerikan të Thesarit, Scott Bessent. Sipas palës amerikane, diskutimet janë përqendruar te plani i

presidentit Donald Trump për paqen në Ukrainë, ndërsa një burim për “Reuters” është shprehur se Bessent e ka bërë të qartë se lehtësimi ekonomik për Rusinë nuk është i mundur pa përfundimin e luftës. Përplasjet politike kanë rrezikuar të lënë në plan të dytë agjendën ekonomike të samitit, ku diskutohen rritja globale, ndikimi i luftës në Iran në sektorin e energjisë, suficitit tregtar i Kinës dhe ndikimi i investimeve masive



në inteligjencën artificiale. Ndërkohë, ministrat evropianë kanë refuzuar të shfaqen në fotografinë

tradicionale të familjes së G20-s me homologun rus. Fotografia është realizuar pa Siluanovin.

KRYETARËT E KOMUNAVE PROTESTUAN KUNDËR QEVERISË, LV-JA DOLI KUNDËR

- Kryetarët e komunave kanë kërkuar mbrojtjen e buxheteve dhe kompetencave lokale, ndërsa përfaqësuesit e LV-së e kanë kundërshtuar protestën, duke e cilësuar të motivuar politikisht

Kryetarët e disa komunave të Kosovës kanë protestuar para qeverisë, duke kërkuar mbrojtjen e buxheteve, pronës dhe kompetencave komunale si dhe kompensimin e obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive. Protesta, e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, është mbështetur nga kryetarët e komunave që drejtohen nga PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca, ndërsa është kundërshtuar nga kryetarët e LV-së të cilët e kanë cilësuar të motivuar politikisht

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Disa prej kryetarëve të komunave të Kosovës kanë protestuar në Prishtinë për disa çështje, për të cilat pretendojnë se po u cenohen të drejtat nga niveli qendror. Në protestën e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) kanë marrë pjesë krerë të komunave që udhëhiqen nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca, ndërsa kanë munguar kryetarët që vijnë nga Lëvizja Vetëvendosje



(IV).

Kryetarët e komunave si Prishtina, Prizreni, Ferizaj, Drenasi, Suhareka, Rahoveci, Vushtrria, Lipjani e të tjera kanë dalë në protestë para objektit të Qeverisë për, siç kanë deklaruar, mbrojtjen e buxheteve, pronës dhe kompetencave komunale, si dhe kompensimin e obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive.

Kryetari i Ferizajt, njëherësh kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu nga PDK-ja, ka deklaruar se tash e disa vite kërkesat e qytetarëve për projekte të reja hasin në përgjigjen se nuk ka buxhet. "Mos ua merrni komunave atë që u takon qytetarëve", i ka bërë thirrje ekzekutivit Aliu para protestuesve, duke kërkuar që Qeveria dhe Kuvendi të mos marrin vendime për komunat pa i përfshirë ato.

Sipas tij, nga viti 2022 deri në vitin 2026, nga buxhetet komunale janë marrë qindra miliona euro për të përmbyshur obligime të kontratave kolektive. "Me këto

mjete do të ndërtoheshin shkolla, çerdhe, rrugë, kanalizime, objekte sportive", ka thënë ai. Që nga viti 2014, Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Arsimit në Kosovë kanë nënshkruar së paku tri kontrata kolektive për të përmirësuar të drejtat e punëtorëve. Ndërsa kryetari i Prishtinës, Përparim Rama nga LDK-ja, është shprehur para protestuesve se partia në pushtetin qendror po përdor institucionet për të ndëshkuar qytetarët. "Aty ku Vetëvendosja nuk fitoi, Qeveria po e bllokoi buxhetin dhe investimet", ka deklaruar Rama. Sipas Ramës, është paradoks që

kryetarët e komunave të protestojnë që ekzekutivi të mos ua bllokojë zhvillimin e qyteteve. E Smajl Latifi, kryetar i Rahovecit nga Aleanca, është ankuar për vonesën e kompensimit të dëmeve bujqësore nga Qeveria, që sipas tij ndër vite ka prekur shumë fermerë të kësaj komune. "Ka raste të dëmeve të evidentuara nga viti 2022 që ende vazhdojnë të mbesin pa u kompensuar", ka deklaruar Latifi në protestë, duke i bërë thirrje Qeverisë të krijojë një mekanizëm të përhershëm për kompensimin e dëmeve. Në protestë nuk kanë marrë pjesë kryetarët të komunave që vijnë nga radhët e LV-së, parti kjo që udhëheq me Qeverinë në detyrë të Kosovës. Të njëjtë kanë shprehur kritika për këtë protestë.

Kryetari i Mitrovicës së Jugut, Faton Peci, e ka kundërshtuar protestën, duke deklaruar se ajo "nuk e ka hallin e qytetarit, por agjendën e pazarit", duke vlerësuar se është tërësisht politike.



"Qindra milionat e barrës financiare të komunave nuk janë obligime të Qeverisë së Albin Kurtit, por janë obligime të Qeverisë PAN", ka shkruar Peci në "Facebook".

Alban Hyseni, kryetar i Gjilanit, është shprehur se Asociacioni i Komunave duhet të përfaqësojë të gjitha 38 komunat dhe jo të përdoret për përplasje politike me Qeverinë. "Nëse flasim për dëmet financiare të komunave, atëherë duhet të flasim edhe për pasojat e kontratës kolektive të nënshkruar gjatë qeverive Mustafa dhe Haradinaj", ka shkruar ai në



"Facebook".

Thirrje që Asociacioni të mos përdoret për përplasje politike me Qeverinë e Kosovës ka bërë edhe kryetari i Podujevës nga LV-ja, Shpejtim Bulliqi. "Mjetet për komunat nuk janë zhdukur dhe as nuk janë 'marrë' nga Qeveria, siç thuhet në pretendimet e Drejtorit Ekzekutiv Sazan Ibrahimit. Ato kthehen sërish në komuna, përmes projekteve investuese që kanë për qëllim përmirësimin e drejtpërdrejtë të jetës së qytetarëve", ka shkruar Bulliqi në "Facebook".

Organizatorët e protestës kanë bërë të ditur se kërkesat e komunave për Qeverinë do t'i dërgohen zyrtarisht edhe kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti.

Lushtaku: Qeveria po ua cenon kompetencat komunave, pushteti lokal nuk do të heshtë

Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka reaguar pas protestës së komunave të Kosovës kundër, siç është shprehur ai, qasjes së Qeverisë për dobësimin e pushtetit lokal dhe cenimin e kompetencave të komunave. Lushtaku ka deklaruar se Qeveria nuk mund t'ua marrë kompetencat

pushtetin lokal dhe po cenon kompetencat e komunave. Qeveria nuk mund t'i marrë kompetencat komunave, t'ua lërë barrën financiare dhe pastaj të kërkojë llogari për shërbimet ndaj qytetarëve. Kjo protestë është mbi të gjitha përplasje mes demokracisë dhe autoritarizmit. Pushtetet komunale janë të zgjedhura nga qytetarët dhe kanë mandat kushtetues e ligjor për t'i udhëhequr punët e tyre. Çdo përpjekje për t'i dobësuar ato është përpjekje për ta larguar vendimmarrjen nga qytetari. Sot ishte protesta e komunave, por mbi të gjitha ishte paralajmërim politik se pushteti lokal nuk do të heshtë përballë padrejtësive dhe cenimit të autonomisë së tij. Kosova ka nevojë për më shumë decentralizim, më shumë kompetenca dhe më shumë fuqi për komunat dhe jo për një Qeveri që kërkon ta mbledhë çdo vendim në kolltuqet e tyre!", ka shkruar Lushtaku në "Facebook".

"Boll është boll", Haradinaj: Regjimi Kurti nuk u la rrugë tjetër kryetarëve të komunave

Ish-kryetari i Aleancës, Ramush Haradinaj, ka reaguar lidhur me protestën e kryetarëve të komunave para objektit të Qeverisë së Kosovës. Përmes një postimi në "Facebook", Haradinaj ka kritikuar Qeverinë Kurti, duke deklaruar se kryetarëve të komunave nuk u është lënë alternativë tjetër përveç protestës. "Regjimi Kurti nuk ju la rrugë tjetër kryetarëve të komunave dhe komunave përveç të dalin në rrugë", ka shkruar Haradinaj. Ai e ka shoqëruar reagimin me mesazhin e shkurtër: "Boll është boll".



MARRËVESHJA PËR PRESIDENTIN: KONSENSUS ME SHUMË PIKËPYETJE

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Marrëveshja në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kandidaturën e Bekim Sejdiut për president të shtetit është vlerësuar si zhvillim pozitiv pas një periudhe të gjatë të bllokadës institucionale, por analistët paralajmërojnë se ende nuk ka garanci për zbatimin e saj. Sejdiu, gjatë prezantimit kandidat për president më 31 gusht, ka deklaruar se e ka pranuar kandidaturën duke pasur parasysh kontekstin politik në të cilin ndodhet Kosova. Vendi ka mbajtur zgjedhje parlamentare në qershor pikërisht për shkak të moskonsensusit mes partive për kreun e shtetit, të tretat që nga shkurti i vitit 2025. Agon Maliqi, njohës i çështjeve politike në Kosovë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë (REL)" se pas rreth dy vjetësh të bllokimit institucional dhe paralizës politike, arritja e konsensusit mes dy partive për çështjen e presidentit duhet përshëndetur. Megjithatë, ai ka thënë se "nuk ka vend për entuziazëm të tepëruar" pasi, sipas tij, marrëveshja mund të hasë në pengesa në zbatim. Në anën tjetër, analisti Dritëro Arifi e ka kritikuar mënyrën se si është zhvilluar procesi i negociatave, duke e cilësuar atë jotransparent. "I gjithë procesi ka qenë në terr informativ, sikur të ishin dy kompani private duke

negociuar për një tender apo për një projekt", ka deklaruar Arifi për "Radion Evropa e Lirë".

Vlerësimet për Bekim Sejdiun

Sa i përket figurës së Bekim Sejdiut, Maliqi ka thënë se profili i tij profesional përputhet me përgjegjësitë e presidentit, duke përmendur përvojën e tij në diplomaci dhe drejtësi. Mirëpo, Maliqi ka vlerësuar se ka dilema rreth kandidaturës së Sejdiut, për atë se sa do të mund të përballojë betejat politike. "Nuk dihet nëse ai do të jetë dikush që do të mund përballat me presionet e një pushteti ekzekutiv, i cili ka treguar tendencë dominimi dhe i cili nga të gjitha institucionet kërkon nënshtrim, duke qenë se ai nuk e ka një parti prapa vetes, edhe pse vjen, kushtimisht thënë, nga orbita e LDK-së", ka deklaruar Maliqi. Ndërkaq sipas Arifit, përvoja profesionale nuk është e mjaftueshme për të vlerësuar nëse një person është i përshtatshëm për postin e presidentit. "Bekim Sejdiu mund të jetë njeri i shkëlqyeshëm, akademik i shkëlqyeshëm, por kjo nuk e bën politikan të shkëlqyeshëm", ka vlerësuar ai. Arifi ka thënë se Sejdiu duhet t'i bëjë të qarta publikisht qëndrimet për disa çështje strategjike, përfshirë gazin amerikan, dialogun strategjik

me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe marrëveshjet e Brukselit dhe Ohrit në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Çështja e përfshirjes në projektet rajonale të gazit, që mbështeten nga ShBA-ja, ka qenë kërkesë edhe e partive opozitare dhe e vetë Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Por, një hap i tillë nuk është ndërmarrë deri më tani nga qeveria në detyrë e udhëhequr nga Albin Kurti. Ndërkaq, vitin e kaluar ShBA-ja ka pezulluar nisjen e dialogut strategjik, duke u thirrur në "shqetësime" lidhur me "veprimet e qeverisë" së Kurtit, që "kanë rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë".

Dilemat brenda LDK-së

Një prej sfidave kryesore për zgjedhjen e Sejdiut mbeten dallimet brenda LDK-së dhe sigurimi i votave të nevojshme në Kuvend. Maliqi ka thënë se çështja e numrave e vendos LDK-në në një pozitë të vështirë dhe se partia mund të detyrohet të kërkojë mbështetje edhe jashtë radhëve të saj. Por, sipas tij, problemi mund të jetë edhe më i madh se sigurimi i votave. "Problemin më të madh nuk e shoh te numrat sa e shoh te mundësia e zhvlerësimit të procesit nga Gjykata Kushtetuese, meqë për momentin me këtë Kuvend jemi në një situatë të paqartë juridike", ka vlerësuar Maliqi. Ky qëndrim i Maliqit është

Kryesia e LDK-së mbështet marrëveshjen me LV-në për presidentin

Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës ka miratuar unanimitisht marrëveshjen politike me Lëvizjen Vetëvendosje, me ç'rast ka mbështetur nominimin e Bekim Sejdiut për president të Kosovës. Pas shqyrtimit, Kryesia e LDK-së ka miratuar me unanimitet të plotë marrëveshjen e arritur nga ekipi negociues i partisë, duke mbështetur njëkohësisht nominimin e profesor Bekim

Sejdiut për president të Republikës. Sipas LDK-së, vendimi përfaqëson qëndrimin zyrtar dhe institucional të partisë. Kryesia e kësaj partie u bëri thirrje deputetëve të grupit parlamentar të LDK-së që "gjatë procesit të votimit, të veprojnë në përputhje me autorizimet e Kuvendit të partisë, vendimin e Kryesisë dhe përgjegjësinë që mbajnë si përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës".

referencë për afatin kushtetues për konstituimin e Kuvendit. Në një aktgjykim vitin e kaluar, Gjykata Kushtetuese ka thënë se organi ligjvënës duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga data e certifikimit të rezultateve. Ky afat tashmë është tejkaluar, por LV-ja e Kurtit thotë se ka afat 30 ditë nga 6 gushti, kur ka nisur seanca konstituive. Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca, kanë argumentuar se afati kushtetues është shkelur. Dritëro Arifi, ndërkaq, ka thënë se dallimet brenda LDK-së mund të paraqesin problem serioz për marrëveshjen, sidomos për deputetët që kanë qenë kritikë ndaj qeverisë së Albin Kurtit të LV-së. "Është

arritur një marrëveshje vetëm për të akomoduar në zyrë një person dhe për t'ia vazhduar qeverisjen Kurtit, pa asnjë qëndrim politik dhe institucional të LDK-së", ka vlerësuar ai.

A shkohet në zgjedhje nëse Sejdiu dështon të bëhet president?

Nëse Bekim Sejdiu, për të cilin janë pajtuar LV-ja dhe LDK-ja, nuk arrin të zgjidhet president në tri raundet e votimit, ashtu si edhe kundërkandidati i tij, cildo që të jetë, Kushtetuta e Kosovës parasheh shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja. Maliqi ka vlerësuar se në një

GJINI: ALEANCA NUK E VOTON KANDIDATIN SEJDIU PËR PRESIDENT

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka deklaruar se partia e tij nuk do ta votojë Bekim Sejdiun për president të Kosovës, duke theksuar se qëndrimi i Aleancës ka qenë i qartë që nga 7 qershori.

Gjini ka thënë se Aleanca nuk ndihet e obliguar nga marrëveshjet që mund të arrijnë subjektet e tjera politike. “Qëndrimi i Aleancës është i qartë që prej datës 7 qershor. Ne nuk kemi kurrfarë obligimi ndaj çfarëdo marrëveshje që bëjnë dy parti politike të tjera”, ka deklaruar Gjini.

Ai ka kritikuar edhe qeverinë, duke thënë se nuk sheh vullnet për t’u marrë me çështjet që



lidhen me qytetarët dhe të ardhmen e vendit. “Nuk shohim kurrfarë vullneti të

kësaj qeverie me u marrë me çfarëdo teme që ka të bëjë me qytetarin e Kosovës, me të

ardhmen e vendit, me planifikimet afatgjatë”, është shprehur ai.

I pyetur nëse do t’i përgjigjej një ftese nga Albin Kurti dhe Lumir Abdixhiku për konsultime rreth zgjedhjes së presidentit, Gjini tha se nuk është i interesuar për atë që e cilësoi si “lojëra të fëmijëve”. “S’kam kohë për këso lojërash të fëmijëve që janë me qëllim mashtrimin e opinionit publik dhe dërgimin e Kosovës në zgjedhje”, tha ai.

Gjini ka theksuar se deputetët e Aleancës janë të unifikuar në qëndrimin e tyre dhe se çdo vendim do të merret bashkërisht. “Jemi qind për qind unikë. Çfarëdo vendimi që

merret në Aleancë është unik”, përfundoi Gjini.

Kryetari i Aleancës ka folur edhe për protestën e komunave, duke e vlerësuar situatën aktuale politike dhe institucionale të rëndë për Kosovën. “Sot jemi në situatën që komunat kanë ardhur të protestojnë për shkak se periudha e mashtrimit më të madh në historinë e Kosovës e ka prekur çdo pore të jetës në Kosovë. Kosova është para kolapsit ekonomik e social. Nuk respektohet në arenën ndërkombëtare. Kemi bllokada. Jemi përjashtuar nga dialogu strategjik me Amerikën dhe kemi qenë nën sanksione të Evropës”, ka deklaruar Gjini.

Hamza për Sejdiun: Nuk e votojmë për president



PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka thënë se nëse Bekim Sejdiu zgjidhet president i Kosovës, ai duhet ta luajë rolin e një presidenti unifikues, por ka vlerësuar se fillimet nuk janë të mira. Në një prononcim për “Kosovapress”, Hamza ka

theksuar se PDK-ja nuk e mbështet kandidaturën e propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. “Nuk ka ndryshim të qëndrimit. Qëndrimi i PDK-së është i qartë, nuk jemi pjesë e marrëveshjes dhe nuk e votojmë zotërinë Sejdiu për

president”, ka deklaruar Hamza. Sipas tij, Sejdiu deri tani nuk ka zhvilluar asnjë komunikim apo diskutim me PDK-në për ta kërkuar mbështetjen e saj për zgjedhjen në postin e presidentit. “Asnjë komunikim. Asnjë diskutim nuk ka. Ai, nëse zgjidhet, duhet të luajë rolin e presidentit

unifikues. Fillimet nuk janë të mira”, ka theksuar Hamza.

I pyetur nëse do të pranonte të takojë me kandidatin e propozuar nga LV-ja dhe LDK-ja për t’i marrë garanci se do të jetë president unifikues, Hamza ka thënë se tashmë është vonë. “Vonë është tashmë”, ka përfunduar ai.

skanar të tillë zgjedhjet e parakohshme do të ishin të pashmangshme.

“Kam përshtypjen se në këtë skanar zgjedhjet e parakohshme janë të pashmangshme”, ka thënë ai. Arifi, ndërkaq, ka paralajmëruar se dështimi i zgjedhjes së presidentit do ta ndërlikonte edhe më shumë gjendjen institucionale të Kosovës. “Kosova është jashtëzakonisht jashtë çdo ekuacioni diplomatik”, ka deklaruar Arifi. LV-ja e Albin Kurtit ka fituar 53 mandate në zgjedhjet e qershorit dhe, së bashku me deputetët e komuniteteve joshumicë, ka të paktën 61 vota, të mjaftueshme për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë së re.

Për zgjedhjen e presidentit, megjithatë, kërkohet prania e të paktën 80 deputetëve në sallën e Kuvendit, i cili ka gjithsej 120 ulëse.

Nëse LV-së i shtohen 18 deputetët e LDK-së, numri arrin në të paktën 81 vota. Kjo do të ishte e mjaftueshme për zgjedhjen e presidentit, me kusht që të paktën 80 deputetë të jenë të pranishëm gjatë votimit.

Megjithatë, deri më tani, një deputet i LDK-së, ish-kryeministri Avdullah Hoti, publikisht ka dalë kundër kandidaturës së Sejdiut. Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca më herët kanë shprehur qëndrimin e tyre se do të qëndrojnë në opozitë. Kjo e dyta ka paraqitur gjashtë pika, të cilat, nëse LV-ja i plotëson, atëherë ajo do të japë shtatë

votat e saj për formimin e institucioneve.

Emri i Sejdiut, si kandidat i përbashkët i LV-së dhe LDK-së, ka ardhur pas disa raundesh të bisedimeve mes dy partive, fillimisht për bashkëqeverisje, të cilat kanë dështuar, më pas negociatave që janë përqendruar vetëm te çështja e presidentit.

Nëse Sejdiu do ta marrë mbështetjen e mjaftueshme të deputetëve, ai do të bëhet presidenti i gjashtë i Kosovës.

ÇFARË QËNDRIMI KANË PARTITË E KOMUNITETEVE JOSHUMICË PËR KANDIDATURËN E SEJDIUT?

Përfaqësues të partive nga komunitetet joshumicë kanë shprehur qëndrimin se Kosova duhet t’i formojë sa më shpejt institucionet e reja, të dala nga zgjedhjet e qershorit, përfshirë edhe zgjedhjen e presidentit. Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, më 31 gusht, e kanë paraqitur Bekim Sejdiun si kandidat të përbashkët për president.

Moszgjedhja e presidentit ka nxitur zgjedhjet parlamentare të qershorit, të tretat që nga shkurti i vitit 202 dhe në rast të dështimit të zgjedhjes së kreut të ri të shtetit, vendi do të përballej me votime të reja.

Nga 120 vende në Kuvend, 20 u përkasin komuniteteve joshumicë: dhjetë komunitetit serb dhe dhjetë të tjera komuniteteve joserbe. Emilja

Rexhepi nga Partia e Re Demokratike, nga radhët e komunitetit boshnjak, ka deklaruar se e përkrah Sejdiun për president.

Në një prononcim për “Radion Evropa e Lirë”, ajo ka shpresuar që të gjithë deputetët e LDK-së ta përkrahin Sejdiun, teksa ka shtuar se vendi duhet t’i ketë sa më shpejt institucionet e reja. “Është mirë që më në fund kemi një kompromis mes LV-së dhe LDK-së për propozimin e një kandidati, Bekim Sejdiut, për president të shtetit, dhe shpresoj që të gjithë deputetët nga grupi parlamentar i LDK-së do ta mbështesin. Menjëherë po shoh në media reagimin e deputetit Hoti se nuk do të votojë, gjë që mund të paraqesë problem gjatë votimit nëse të gjithë nuk janë unikë”, ka thënë Rexhepi.

Ndërkaq Elbert Krasniqi nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës ka thënë shkurt për “REL”-in se e përkrah këtë kandidaturë.

Nenad Rashiq, deputet nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, nga radhët e komunitetit serb, ka ofruar mbështetje për kandidaturën. “Po, e përkrah çdo marrëveshje mes partive politike për kandidat unifikues”, ka thënë ai në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë.

Në anën tjetër, Fikrim Damka nga partia turke KDTP i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se të gjitha partitë politike duhet ta kenë prioritet tejkalimin e ngërçit dhe formimin e institucioneve të reja. Ai e ka vlerësuar zhvillim pozitiv dhe

hap të rëndësishëm pajtueshmërinë politike për emrin e Sejdiut. “Qëndrimi ynë është i qartë: Kosova nuk ka më kohë për zvarritje dhe bllokada të reja politike. Interesi shtetëror dhe institucional duhet të jetë mbi dallimet politike. Prandaj, e mbështesim përmbylljen sa më të shpejtë të procesit të konstituimit të institucioneve dhe zhvillimin e procesit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me Kushtetutën”, ka thënë ai.

Damka ka shtuar se çdo marrëveshje politike, që i shërben stabilitetit institucional, funksionalizimit të shtetit dhe avancimit të interesave të qytetarëve, “duhet të trajtohet me përgjegjësi dhe seriozitet”.

Nga koalicioni VAKAT i kanë thënë “Radios Evropa e Lirë” se do të marrin pjesë në procesin e zgjedhjes së presidentit dhe do të votojnë. Rasim Demiri nga ky koalicion ka thënë se kjo është përgjegjësi politike dhe institucionale. “Votën tonë do ta japim me përgjegjësi, në përputhje me parimet tona politike, interesat e qytetarëve dhe të komuniteteve që përfaqësojmë, si dhe në bazë të konsultimeve dhe marrëveshjeve që do të arrihen”, ka thënë ai për “REL”-in.

VAKAT, ka thënë ai, konsideron se presidenti i vendit duhet të jetë një person që përfaqëson unitetin e të gjithë qytetarëve, respekton Kushtetutën dhe është garantues i barazisë dhe i të drejtave të të gjitha

komuniteteve në Kosovë.

Ndërkaq, deputeti i zgjedhur nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Albert Kinolli, po ashtu ka shprehur përkrahjen për kandidaturën e Sejdiut. “Duke parë angazhimet dhe kontributin e tij të deritanishëm, mendoj se i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme për një president konsensual dhe mendoj që zoti (Albin) Kurti dhe zoti [Lumir] Abdixhiku kanë bërë zgjedhjen e duhur dhe ne si subjekt politik e përshëndesim dhe njëherësh e përkrahim”, ka thënë Kinolli për “REL”-in.

“Radio Evropa e Lirë” ka kontaktuar edhe eksponentë nga Lista Serbe, nga Unioni Socialdemokrat, Partia Socialdemokrate e Ashkalinjve dhe Partia e Bashkuar Gorane, për ta kuptuar qëndrimin e tyre për çështjen e presidentit dhe kandidaturën e Sejdiut, por ende nuk ka marrë përgjigje.

Sejdiu, 52-vjeçar, nëse siguron mbështetjen e nevojshme të deputetëve, do të bëhet presidenti i gjashtë i Kosovës. Ndërsa teksa e kanë mirëpritur marrëveshjen mes LV-së dhe LDK-së për presidentin, analistët i kanë thënë “REL”-it se druajnë që pakti do të hasë në probleme gjatë zbatimit.

LV-ja dhe LDK-ja së bashku kanë 71 vota, ndërsa për zgjedhjen e presidentit kërkohet që të paktën 80 deputetë të qëndrojnë në sallë gjatë votimit. Votat e LDK-së duket se nuk janë të unifikuara, pasi Avdullah Hoti publikisht ka dalë kundër kandidaturës së Sejdiut.

ÇEKU TAKON DREJTUESIT E SBASHK-ut, DISKUTOJNË PËR FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR DHE RËNDËSINË E BASHKËPUNIMIT



PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ministri në detyrë i Arsimit dhe Shkencës, Hajrullah Çeku, ka vizituar Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor. Sipas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Çeku është pritur në takim nga kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i përgjithshëm Ymer Ymeri.

Në takim është diskutuar për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe përfaqësuesve të komunitetit arsimor si dhe për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. “Gjatë takimit u diskutua për përgatitjet rreth fillimit të vitit të ri shkollor, rolin kyç të mësimdhënësve, rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe përfaqësuesve të komunitetit arsimor, dhe përgjegjësitë,

përveçse synimin e përbashkët për cilësi të arsimit në vend”, është me dije në njoftim. Sipas këtij njoftimi, kryetari i SBASHK-ut e ka vlerësuar vizitën e ministrit Çeku si dhe ka shprehur mbështetjen për Strategjinë e Arsimit 2035+, duke e cilësuar atë, siç është thënë në njoftim, si një dokument të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të arsimit gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm.

LËVIZJA FOL FITON RASTIN GJYQËSOR PËR MBROJTJEN E LIRISË SË SHPREHJES DHE INTERESIT PUBLIK

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e ngritur ndaj Lëvizjes FOL, duke vlerësuar se deklaratat e organizatës lidhur me interesin publik dhe llogaridhënien e zyrtarëve janë të mbrojtura nga liria e shprehjes dhe debati publik. Sipas Lëvizjes FOL, vendimi është marrë më 21 korrik 2026, në kuadër të lëndës C.nr.581/15, ndërsa gjyqtarja Shpresa Veselaj ka vlerësuar se rasti është në përputhje me

praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshirë rastin “Lingens kundër Austrisë”. Gjykata ka theksuar se liria e shprehjes përfshin edhe deklaratat kritike dhe shqetësuese, veçanërisht kur ato lidhen me persona dhe funksione publike. Në aktgjykim thuhet se mediet, por edhe organizatat e shoqërisë civile si Lëvizja FOL, gëzojnë një shkallë të lartë mbrojtjeje kur veprojnë në kuadër të debatit publik. Lëvizja FOL e ka cilësuar

vendimin si një fitore të rëndësishme jo vetëm për organizatën, por edhe për shoqërinë civile dhe mediet që angazhohen për transparencë, llogaridhënie dhe mbrojtjen e interesit publik. Organizata ka falënderuar avokatin Admir Salihu i cili e ka përfaqësuar atë pro bono gjatë procesit gjyqësor. Nga Lëvizja FOL kanë deklaruar se do të vazhdojnë të angazhohen për mbrojtjen e të drejtës për shprehje të lirë në funksion të interesit publik.



LV-ja ZHVILLON AKSION SIMBOLIK PARA KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR GJENDJEN E MBETURINAVE

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Lëvizja Vetëvendosje, Qendra në Prishtinë, ka zhvilluar të martën një aksion simbolik para objektit të komunës së Prishtinës, në shenjë proteste për gjendjen me mbeturinat në kryeqytet. Gjatë aksionit hyrja e objektit të komunës është bllokuar me thasë me mbeturina. Megjithatë, aksioni ka zgjatur vetëm pak minuta, pasi ndërmarrja “Pastrimi” ka reaguar dhe i ka larguar thasët nga hyrja e komunës. Asamblisti i LV-së në komunën e Prishtinës, Egzon Azemi, ka deklaruar se përmes këtij aksioni është synuar të



tërhiqet vëmendja për, siç e ka quajtur ai, gjendjen alarmante

me mbeturinat në kryeqytet. “Ky aksion simbolik shpërfaq

një problematikë jashtëzakonisht shqetësuese në Komunën e Prishtinës. Problemi i mbeturinave nuk ka qenë kurrë në historinë e kryeqytetit në këtë nivel kaq alarmant. Shumica e lagjeve të Prishtinës janë shndërruar pothuajse në deponi mbeturinash”, ka deklaruar Azemi. Ai ka kritikuar kryetarin e Prishtinës, Përparim Ramën, duke e akuzuar se nuk po merret mjaftueshëm me problemet e qytetit. “Zotëri Rama, në vend se të ishte kryetar i Komunës së kryeqytetit, është shndërruar

në një vegël të Partisë Demokratike”, ka deklaruar Azemi. Ai ka shtuar se komuna e Prishtinës për vite me radhë nuk ka blerë mjete të reja për pastrimin e mbeturinave, ndërsa ka kritikuar edhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes “Pastrimi”. Azemi ka kritikuar edhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes “Pastrimi”, duke thënë se problemet me mbeturinat dhe çështjet e tjera në kryeqytet duhet të jenë në fokus të kryetarit. Pas këtij aksioni të zhvilluar para objektit të komunës, aty është parë edhe Inspektorati.

RAGMI MUSTAFI: KËTË VIT S’KA LIBRA FALAS PËR NXËNËSIT NË LUGINË, SERBIA PO CENON TË DREJTËN PËR ARSIM

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ish-kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Ragmi Mustafi, ka thënë se nxënësit shqiptarë në Luginën e Preshevës e kanë nisur vitin e ri shkollor pa libra falas pasi, sipas tij, institucionet e Serbisë kanë bllokuar mjetet e ndara nga Qeveria e Kosovës për tekstet mësimore. Mustafi ka bërë me dije se 3 686 nxënësit shqiptarë të shkollave fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë nuk i kanë marrë librat falas në ditën e parë të vitit shkollor. “Më 1 shtator

2026, 3.686 nxënësit shqiptarë të shkollave fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë e nisin vitin shkollor pa librat falas që u takojnë. Jo sepse librat mungojnë. Jo sepse Kosova nuk i ka ndarë mjetet. Jo sepse Këshilli Kombëtar Shqiptar dhe shkollat nuk janë përgatitur. Por sepse institucionet e Serbisë kanë bllokuar mjetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të dedikuara për tekstet mësimore të fëmijëve shqiptarë”, ka shkruar Mustafi në “Facebook”.



Sipas tij, rreth 2 000 nxënësit shqiptarë të tri shkollave të

mesme në Preshevë dhe Bujanoc vazhdojnë të mësojnë pa kompletet e teksteve në gjuhën shqipe, sipas programeve të reformuara. Mustafi ka kritikuar institucionet serbe, duke vlerësuar se bllokimi i mjeteve të dedikuara për librat shqip cenon të drejtën për arsim, barazinë e qytetarëve dhe ruajtjen e gjuhës dhe identitetit. “Kur një shtet bllokoi financimin e librave për fëmijë për shkak të prejardhjes së mjeteve, ai ndërhyr

drejtpërdrejt në të drejtën për arsim, në barazinë e qytetarëve dhe në ruajtjen e gjuhës e të identitetit”, ka shkruar ai. Ai ka thënë se tashmë rrezikohet edhe pajisja falas me libra e nxënësve shqiptarë të shkollave fillore, duke kërkuar që të garantohej e drejta e tyre për tekste mësimore në gjuhën amtare. “Mund t’i bllokoni mjetet, por nuk mund ta bllokoni të drejtën tonë për librin shqip. Libra falas. Barazi për çdo nxënësit”, ka shkruar Mustafi.

Haradinaj në përkrahje të marshit të 12 shtatorit: Çlirimtarët i presim në Kosovë

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Marshi për drejtësi me moton "Kosova po pret", i cili do të mbahet më 12 shtator, është duke marrë mbështetje të gjerë anekënd trojeve shqiptare. Ky marsh do të mbahet në mbështetje të liderëve të UÇK-së, Hashim

Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ndaj të cilëve Gjykata Speciale pritet të shpallë aktgjykimin më 16 shtator.

Ish-kryeministri i Kosovës dhe ish-komandanti i UÇK-së në Zonën e Dukagjinit, Haradinaj,

përmes një videomesazhi ka shprehur përkrahjen e tij për marshin e paralajmëruar më 12 shtator në Prishtinë. Haradinaj ka bërë thirrje për pjesëmarrje në këtë marsh, duke deklaruar se ai do të mbahet në përkrahje të

çlirimtarëve dhe drejtësisë. "Më 12 shtator, të gjithë bashkë në sheshin 'Skënderbeu' në Prishtinë! Në përkrahje të çlirimtarëve. Në përkrahje të drejtësisë. I presim në Kosovë", ka deklaruar Haradinaj.



KUSH ËSHTË NË SKENARIN E SHTETEVE QË E FINANCOJNË GJYKATËN SPECIALE?



Shkruan: Milazim KRASNIQI

Ndonëse janë bërë e bëhen përpjekje të mos duket, Kosova është peng i Gjykatës Speciale, që nga dita kur ajo gjykatë u themelua me presion e terror diplomatik ndërkombëtar. Kosova që nga ajo ditë ka hyrë në një rrugë, e cila mund ta çojë edhe drejt trazirave e dezintegrimit. Nëse Gjykata merr vendim dënues, reagimi shqiptar mund të jetë dramatik, sepse në atë rast jo vetëm që dënohen figurat kryesore të UÇK-së e të ndërtimit të shtetit të Kosovës, por shfaqet rreziku real i ndryshimit të historisë së ndërtimit të shtetit tonë. Faktikisht, Gjykata Speciale është imponuar pikërisht për këtë qëllim. Me synimin e disa shteteve që të relativizohen krimet e Serbisë dhe t'i bëhen lëshime Rusisë, Gjykata Speciale tërë këto vite ka zbatuar arrogancë e

mospërfillje ndaj institucioneve të Kosovës, sikur ato të mos ekzistonin dhe të mos ishin themeluese të asaj gjykatë. Kjo është vetëm ana banale e skenarit. Ana e padukshme e skenarit është shumë më djallëzore, shumë më ogurzezë. Ana e saj e padukshme tash gjashtë vite e ka krijuar klimën për dënimin e protagonistëve të UÇK-së, që janë në Hagë, duke tentuar ta blejë pajtimin e popullit të Kosovës për atë dënim eventual. Ja si! E para, qeveria e Kosovës, që nga koha e arrestimit të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit, ka mbajtur qëndrim të ftohtë ndaj kauzës së tyre. Ky qëndrim ka përfshirë anëtarësinë e partive të koalicionit dhe simpatizantët e tyre, duke krijuar një masë kritike që faktikisht e përkrahin

Gjykatën Speciale dhe ëndërrojnë që të akuzuarit të dënohen. Ky qëndrim e disponim është absurd, sepse është në kundërshtim me qëndrimin që ka pasur LVV kundër Gjykatës Speciale. E dyta, që është edhe më e frikshme është se një pjesë e mërgatës sonë, duket si e rekrutuar në një skenar në shtetet që e financojnë Gjykatën Speciale, sidomos Gjermanisë. Ata që janë shpërngulë në valën e dirigjuar në vitin 2015, me ç'rast u nxorën jashtë edhe shumë dëshmitarë, duken si kontigjenti më militant kundër UÇK-së dhe drejtuesve të saj. Me sa duket, si produkt i këtij skenari është edhe mënyra e çuditshme e votimit për LV-në në diasporë. Votimi si ky i zgjedhjeve të fundit, fundit ku LV-ja merr mbi 80 për qind të votave në

diasporë, nuk ka as logjikë politike, as sociale, as ekonomike, as farefisnore, as fetare, as rajonale. Atje votohet për kandidatë, të cilët votuesit nuk i njohin. Ata nuk votojnë për ndonjë program në Kosovë, sepse nuk jetojnë në Kosovë, prandaj asnjë program nuk u paraqet interes për ta, për asgjë. E vetmja arsye logjike, sado që nuk mund të vërtetohet lehtë sot, është se janë votues të dirigjuar nga qarqe të ndryshme të shteteve evropiane, të cilat e financojnë Gjykatën Speciale dhe prandaj janë të interesuara që ajo Gjykatë të dënojë të akuzuarit. Rekrutimi i një pjese të mërgatës në atë projekt, bashkë me disa lëvizje fashiste që kërkojnë konvertimin me dhunë të shqiptarëve myslimanë të Kosovës, për ato shtete ka edhe një qëllim praktik: po të mbeteshin ata simpatizues të UÇK-së dhe shqiptarët unikë, e po qe se do të dënoheshin drejtuesit e saj nga Gjykata Speciale të cilën ato shtete e financojnë, në ato vende mund të priteshin incidente, trazira. Pra, neutralizimi i mërgatës dhe nxitja e ekstremizmit katolikocentrist mund të jetë bërë edhe për këto qëllime. Nëse është kështu, atëherë qysh tash mund të kemi drojë se Gjykata Speciale do të marrë vendim që është në frymën e politikës së atyre shteteve, të cilat që nga fillimi kanë synuar relativizimin e krimeve të Serbisë dhe krijimin e një lloj

barazie ndërmjet krimeve të shtetit serb dhe krimeve ordinere të individëve në Kosovë.

Gjykata Speciale as që i ka ndjekur dorasit. Gjykata Speciale është mjaftuar të marrë peng drejtuesit e UÇK-së dhe figurat qendrore të ndërtimit të shtetit të Kosovës. Por ashtu e ka marrë peng edhe politikën në Kosovë, e cila tash sa vite është e bllokuar, e konfrontuar dhe në prag të konfliktit. Imponimi i Planit Franko-Gjerman dhe i Aneksit të Ohrit nga Gjermania e nga Franca praktikisht është projekt për copëtimin dhe federalizimin e Kosovës. Imponimi i këtij plani ka qenë i pamundur pa e pasur Kosova si shpatë mbi kokë Gjykatën Speciale dhe pa iu mbajtur peng në Hagë drejtuesit kryesorë të UÇK-së dhe të shpalljes së pavarësisë.

E treta, edhe krizat e zgjedhjeve pa zgjidhje, me shumë gjasë janë programuar, për ta mbajtur Kosovën peng, të dobët dhe në mbikëqyrje, në mënyrë që reagimi ndaj Gjykatës Speciale të amortizohet më lehtë. Por një gjë nuk e kanë llogaritur mirë: mënyrën e reagimit shqiptar, kur u prekë thika në asht. Ata duhet të llogarisin se nëse ndodhë dënim, Kosova vërtet mund të destabilizohet. Ndërsa destabilizimi nuk është interes i NATO-s, as i BE-së, as i ShBA-së. Sidomos jo i Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Francës, fjala vjen. Destabilizimi mund të jetë vetëm interes i Rusisë dhe aleatëve të saj.

Haxhiu dekoron Komitetin Norvegjez të Helsinkit me Medaljen Presidenciale të Meritave

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka dekoruar sot Komitetin Norvegjez të Helsinkit me Medaljen Presidenciale të Meritave, në shenjë mirënjohjeje për kontributin në dokumentimin dhe ndërkombëtarizimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Kosovë. Me këtë rast, Haxhiu ka pritur në takim sekretaren e përgjithshme të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Berit Nising Lindeman,

zëvendëssekretarin e përgjithshëm Gunnar M. Ekelove-Slydal. Sipas Haxhiut, në periudhën kur shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë nuk kishin marrë vëmendjen e mjaftueshme ndërkombëtare, Komiteti Norvegjez i Helsinkit ka qenë ndër organizatat e para përëndimore që i ka dokumentuar këto shkelje dhe i ka bërë të njohura në arenën ndërkombëtare.

Ajo ka vlerësuar se përmes këtij angazhimi Komiteti ka kontribuar që çështja e Kosovës

të vendosej në agjendën ndërkombëtare. "Kosova nuk i harron miqtë që i qëndruan pranë në periudha të vështira", ka deklaruar Haxhiu, duke theksuar se dekorata është shprehje e mirënjohjes për angazhimin e gjatë dhe parimor të Komitetit në rrugën e Kosovës drejt lirisë.

Haxhiu ka vlerësuar veçanërisht rolin e organizatës në dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe në ngritjen e vetëdijes ndërkombëtare për situatën në Kosovë.



BLLOKADA NË KUVEND MUND TA RREZIKOJË PRODHIMIN E ENERGJISË NË KOSOVË

Licencat e termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B” skadojnë më 4 tetor, ndërsa Bordi i ZRRE-së nuk ka kuorum për t’i vazhduar ato. ZRRE-ja thotë se pa licenca KEK-u nuk ka bazë ligjore për prodhim. Ekspertët paralajmërojnë se ndërprerja eventuale e prodhimit do ta rriste ndjeshëm varësinë nga importi

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Më 4 tetor skadojnë licencat e dy termocentraleve që prodhojnë pjesën dërrmuese të energjisë elektrike në Kosovë.

Nëse deri atëherë nuk funksionalizohet Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), nuk ka kush të marrë vendimin për vazhdimin e licencave të “Kosovës A” dhe “Kosovës B”.

ZRRE-ja konfirmon për Radion Evropa e Lirë se, pa vazhdimin e licencave, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nuk ka bazë ligjore për të vazhduar prodhimin.

Por, as ZRRE-ja dhe as KEK-u nuk sqarojnë se çfarë do të ndodhë konkretisht pas 4 tetorit, nëse deri atëherë problemi nuk zgjidhet.

Radio Evropa e Lirë i ka pyetur të dyja institucionet nëse termocentralet do të duhet ta ndërpresin prodhimin dhe nëse ekziston ndonjë mekanizëm ligjor që do t’ua mundësonte vazhdimin e përkohshëm të punës.

Në këto pyetje nuk ka marrë përgjigje.

Ndërprerja eventuale e prodhimit të KEK-ut do ta rriste ndjeshëm varësinë e Kosovës nga importi i energjisë, ndërsa ekspertët paralajmërojnë për pasoja në sigurinë e furnizimit dhe kosto të mëdha financiare.

Pse licencat nuk mund të vazhdohen?

Problemi qëndron te Bordi i ZRRE-së, institucioni që ka kompetencën për të vendosur për licencimin e prodhuesve të energjisë. Bordi, aktualisht, nuk ka kuorum për vendimarrje, pasi i mungojnë dy anëtarë dhe kryesuesi.

Procedura për plotësimin e këtyre pozitave ka nisur.

Ministria e Ekonomisë ka publikuar listën e kandidatëve të përzgjedhur për dy pozitat e anëtarëve dhe atë të kryesuesit të Bordit.

Por, procedura nuk mund të përfundojë pa Kuvendin. Pas përzgjedhjes, emrat duhet t’i dërgohen Qeverisë, e cila më pas ia përcjell Kuvendit për votim.

Emërimi përfundimtar i anëtarëve të Bordit është kompetencë e deputetëve. “Lista e kandidatëve do të dërgohet pasi të plotësohen kushtet ligjore, duke përfshirë konstituimin e Kuvendit, pasi emërimi i Bordit të ZRRE-së është përfundimisht kompetencë e Kuvendit të Kosovës”, thuhet në një përgjigje të Ministrisë së Ekonomisë për Radion Evropa e Lirë.



KEK-u, ndërkohë, i ka dorëzuar ZRRE-së aplikacionet për vazhdimin e licencave për “Kosovën A” dhe “Kosovën B”.

ZRRE-ja thotë se stafi profesional tashmë i ka trajtuar ato. Por, vendimi përfundimtar nuk mund të merret. “Pa krijimin e kuorumit ligjor, nuk mund të merret vendim përfundimtar lidhur me aplikacionet e KEK-ut”, thotë ZRRE-ja.

Çfarë rrezikohet pas 4 tetorit?

Pas skadimit të licencave, sipas ZRRE-së, vazhdimi i aktivitetit të prodhimit kërkon një vendim të vlefshëm të Bordit. Por, ZRRE-ja nuk ka sqaruar nëse kjo nënkupton se KEK-u do të duhet ta ndërpresë prodhimin menjëherë pas skadimit të licencave.

As KEK-u nuk i është përgjigjur pyetjes së Radios Evropa e Lirë se çfarë do të bëjë nëse hyn në 5 tetor pa licenca të vazhduara dhe nëse ka përgatitur ndonjë plan alternativ për një skenar të tillë.

Pesha e kësaj paqartësie është e madhe, pasi sistemi energjetik i Kosovës vazhdon të varet kryesisht nga termocentralet e

KEK-ut.

Të dhënat e ZRRE-së për vitin e kaluar tregojnë se prodhimi vendor i energjisë elektrike, përfshirë burimet e ripërtëritshme, arriti në 5.298 gigavat-orë (GWh), ndërsa kërkesa e përgjithshme ishte 6.944 GWh.

Vetëm termocentralet e KEK-ut prodhuan 4.687 GWh, apo mbi 88 për qind të gjithë energjisë së prodhuar brenda vendit.

Hidrocentralet dhe burimet e tjera të ripërtëritshme prodhuan rreth 611.5 GWh. Në total, prodhimi vendor mbuloi mbi 76 për qind të kërkesës së konsumatorëve, ndërsa pjesa tjetër u sigurua përmes importit.

Kjo do të thotë se një ndërprerja eventuale e prodhimit nga “Kosova A” dhe “Kosova B” do ta rriste ndjeshëm nevojën e vendit për energji nga jashtë.

“Rast i paprecedent”

Njazi Thaçi, ish-drejtor i Korporatës Energjetike të Kosovës, e cilëson situatën të pazakontë dhe të papranueshme. “Është e paimagjinueshme që blloqet të ndalen për shkak se nuk vazhdohet licenca. Ky është një

rast i paprecedent. Kosova nuk mund të mbetet vetëm me prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme”, thotë Thaçi për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, prodhimi nga burimet alternative është i pamjaftueshëm për të zëvendësuar kapacitetet e KEK-ut. “Kosova nuk ka prodhim të mjaftueshëm nga burimet alternative. Kjo është kërkesë urgjente, e cila kërkon zgjidhje, dhe subjektet politike duhet ta kenë parasysh që të gjejnë mënyrën për konstituimin e Kuvendit”, shton ai.

Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka përmbyllur procesin e konstituimit të nisur më 6 gusht dhe nuk ka një datë për vazhdimin e seancës.

Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve të fundit, dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila është në opozitë, ishin në bisedime për një marrëveshje politike - përfshirë edhe çështjen e presidentit të ardhshëm - përpara se të thirrej vazhdimi i seancës.

Pasditën e 31 gushtit, dy partitë njoftuan se janë pajtuar për emrin e Bekim Sejdiut për postin e presidentit, por mbetet ende e paqartë se si do të vijojë procesi i konstituimit të institucioneve.

Sa mund t’i kushtojë Kosovës?

Ethem Çeku, njohës i çështjeve energjetike, thotë se, pavarësisht situatës së ndërlikuar institucionale - me Qeveri në detyrë dhe pa Kuvend funksional - duhet të gjendet një zgjidhje ligjore që të mos lejohet skadimi i licencave pa mundësi vazhdimi.

Në të kundërtën, sipas tij, Kosova do të bëhej shumë më e varur nga importi i energjisë elektrike. “Kjo do të krijonte një kosto prej qindra miliona eurosh, e cila fillimisht do të binte mbi buxhetin e shtetit dhe më pas do të reflektonte drejtpërdrejt te qytetarët përmes tarifave të energjisë”, thotë Çeku për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, në rast të rritjes së ndjeshme të importeve, furnizuesi mund të kërkojë kompensim apo subvencionim nga Qeveria për kostot shtesë. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) është e obliguar të sigurojë furnizimin e konsumatorëve.

Ajo e blen energjinë kryesisht nga KEK-u, ndërsa mungesën ndërmjet prodhimit vendor dhe kërkesës e mbulon përmes importit. “Në rast të ndryshimeve në bilancin e furnizimit dhe kërkesës, KESCO ndërmerr masat e nevojshme për sigurimin e energjisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ dhe kushtet e tregut”, thonë për Radion Evropa e Lirë nga kjo kompani.

Radio Evropa e Lirë e pyeti KESCO-n se sa energji do të duhej të importonte nëse prodhimi i KEK-ut do të ndërpritej dhe sa mund t’i kushtonte një skenar i tillë.

Kompania nuk dha vlerësime, duke thënë se nuk mund të spekulojë për skenarë hipotetikë dhe se sasitë dhe kostot e importeve varen nga rrethanat dhe kushtet e tregut në kohën përkatëse.

Por, importi i energjisë tashmë i kushton Kosovës qindra miliona euro

Vetëm gjatë vitit 2025, Kosova shpenzoi rreth 240 milionë euro për import të energjisë elektrike, me një çmim mesatar prej 146 eurosh për megavat-orë (MWh).

Kështu, më pak se pesë javë para skadimit të licencave, mbetet e paqartë se çfarë do të ndodhë me prodhimin e energjisë në “Kosovën A” dhe “Kosovën B” nëse deri më 4 tetor nuk funksionalizohet Bordi i ZRRE-së.

KUR AGJENTËT E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE KALUAN KUFIRIN

Një test i brendshëm i sigurisë kibernetike në OpenAI u shndërrua në një demonstrim shqetësues se sa e vështirë mund të bëhet mbajtja nën kontroll e agjentëve të Inteligjencës Artificiale, që tashmë janë bërë gjithnjë e më të aftë

Gjatë disa vlerësimeve të kryera këtë verë, modelet e OpenAI gjetën mënyra për të anashkaluar kufizimet që synonin t'i mbanin të izoluara, krijuan kanale të paautorizuara komunikimi mes tyre, siguruan qasje në internet dhe, në fund, komprometuan sisteme që i përkisnin si OpenAI, ashtu edhe Hugging Face.

Një hetim i pavarur nga METR dhe Redwood Research vlerësoi se rreth 700 agjentë morën pjesë në incidentin që preku Hugging Face, një shifër që OpenAI i tha Reuters se ishte e saktë.

Agjentët shkëmbyen dhjetëra mijëra mesazhe përmes një sistemi komunikimi të improvizuar, duke ndarë mes tyre dobësi sigurie, kredenciale dhe teknika për të dalë përtej mjediseve brenda të cilave supozohej se duhej të vepronin. OpenAI e ka përshkruar episodin si një “goditje paralajmëruese” për industrinë e Inteligjencës Artificiale. Shprehja ka rëndësi, sepse incidenti nuk u shkaktoi nga një model publik që po ndiqte udhëzimet dashakeqe të një përdoruesi.

Ai lindi gjatë vetë kërkimeve të OpenAI, me sisteme eksperimentale të krijuara pikërisht për të testuar kufijtë e asaj që agjentët e avancuar të AI mund të arrinin.

Një test me agjentët e Inteligjencës Artificiale që vazhdoi të përshkallëzohej

Shenjat e para u shfaqën në maj, gjatë testeve të “reinforcement learning” me modele kërkimore që nuk ishin të destinuara për publikun.

Njëri prej tyre, të cilin OpenAI e quan Internal Model 1, ose IM1, u bë faktori kryesor i incidentit që pasoi. Kompania e përshkruan atë si të krahasueshëm për nga shkalla me GPT-5.6 Sol. Modelet po funksiononin me masa sigurie të reduktuara, pasi studiuesit po përpiqeshin të matnin aftësitë e tyre në sigurinë kibernetike.

Shumë prej tyre ishin vendosur brenda kompjuterëve virtualë të izoluar, pa qasje normale në internet dhe pa leje për të komunikuar me agjentë të tjerë.

Më 12 maj, një agjent zbuloi se sistemi i brendshëm Artifactory i OpenAI për menaxhimin e paketave mund të përdorej për të lënë informacione për agjentët e tjerë.

Ajo që nisi si një shënim i thjeshtë e shndërroi praktikisht shërbimin në një tabelë të paautorizuar mesazhesh. Dy javë më vonë, një agjent gjeti një mënyrë për ta përdorur Artifactory si rrugëdalje drejt internetit të hapur.

Nga fundi i qershorit, agjentët kishin shfrytëzuar një tjetër dobësi për të siguruar qasje në nivel administratori në këtë shërbim. Aktiviteti u bë aq intensiv sa më 4 korrik destabilizoi Artifactory. Një ditë më vonë, OpenAI hapi një incident sigurie,

hoqi kredencialet e ekspozuara, forcoi kontrollat dhe rindërtoi shërbimin.

Gjatë këtij procesi u fshi, pa dashje, edhe kanali që agjentët kishin krijuar për të komunikuar mes tyre.

Por nuk qëndroi i fshirë për shumë kohë.

Pasi testet e sigurisë kibernetike rifilluan, agjentët gjetën një mënyrë tjetër për të hyrë në internet dhe rindërtuan tabelën e tyre të mesazheve duke përdorur direktori brenda Artifactory. Ata nisën sërish të ndanin zbulimet dhe, me kalimin e kohës, madje të ndanin punën mes agjentëve që kërkonin dobësi, kredenciale dhe aftësi të tjera të dobishme. Sipas OpenAI, disa prej agjentëve nisën t'i referoheshin rrjetit të krijuar si një “swarm” – tufë – ose “collective”, kolektiv.

Kur këmbëngulja u shndërrua në problem

Një prej gjetjeve më domethënëse lidhet me vetë sfidat që agjentët po përpiqeshin të zgjidhnin. Vlerësimi, i quajtur ExploitGym, përmban 898 detyra të sigurisë kibernetike. Para incidentit, modelet e OpenAI nuk kishin arritur kurrë të përfundonin me sukses 198 prej tyre. Dhe pikërisht këto probleme, në dukje të pazgjidhshme, morën një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Plot 93% e detyrave të diskutuara në tabelën e paautorizuar të mesazheve të agjentëve vinin pikërisht nga ky grup prej 198 problemesh.

Në vend që të arrinin në përfundimin se një problem mund të ishte i pazgjidhshëm dhe të ndalonin, disa prej agjentëve vazhduan të kërkonin rrugë gjithnjë e më të pazakonta për të gjetur një përgjigje.

OpenAI e identifikoi këtë këmbëngulje të tepruar si një prej katër modeleve të sjelljes që qëndronin pas incidentit, së bashku me “reward hacking”, komunikimin e paautorizuar dhe marrjen përsipër nga agjentët të objektivave të njëri-tjetrit.

“Reward hacking” ndodh kur një sistem AI gjen një mënyrë të paparashikuar për të kënaqur mekanizmin që përdoret për të vlerësuar performancën e tij.

Pra, në vend që ta zgjidhnin sfidën në mënyrën që kishin parashikuar studiuesit, disa agjentë kërkuan përgjigje online, testuan infrastrukturën përreth mjedisit të vlerësimit ose u përpoqën të arrinin informacione që mund t'i ndihmonin të merrnin një rezultat më të lartë.

Në disa raste, agjentët vazhduan të kërkonin mënyra të ndërlikuara për të përmbyshur atë që mendonin se kërkonte testi, edhe pasi e kishin tashmë përgjigjen.

OpenAI arriti më vonë në përfundimin se një pjesë e këtij



aktiviteti shtesë nuk do t'ua kishte përmirësuar aspak rezultatet. Për këtë arsye, episodi nuk ishte thjesht një sulm kibernetik konvencional i kryer nga Inteligenca Artificiale. Ai lindi, të paktën pjesërisht, nga fakti se agjentët vazhdonin pa pushim të përpiqeshin të përmbyshnin objektivat që u ishin caktuar, duke gjetur metoda që krijuesit e tyre nuk kishin parashikuar se do t'i përdomin.

Nga OpenAI tek Hugging Face

Deri më 10 korrik, një agjent kishte gjetur kredenciale të Hugging Face të ekspozuara publikisht dhe i kishte ndarë ato me grupin.

Më pas, agjentët kombinuan disa dobësi për të ekzekutuar kod në sistemet e Hugging Face.

Sipas OpenAI, aktiviteti arriti përfundimisht në dhjetëra serverë të Hugging Face. Agjentët ekzekutuan kod në dhjetëra serverë, siguruan qasje “root” në njërin prej tyre, morën një sasi të kufizuar të dhënash private dhe siguruan kredenciale për platformën e komunikimit të kompanisë.

Disa të dhëna private të vlerësimit u kopjuan gjithashtu në një dataset publik të Hugging Face.

Më pas, aktiviteti u rikthyete drejt vetë OpenAI.

Më 19 korrik, sistemet e monitorimit të sigurisë së OpenAI zbuluan sjellje të pazakontë që përfshinte kredenciale të brendshme.

Agjentët kishin siguruar qasje administratori në një cluster kërkimor që mbështeste mjediset me makina virtuale të kompanisë dhe kishin arritur deri tek të dhëna sekrete të cloud-it.

OpenAI nisi të ndalonte testet aktive të ExploitGym dhe zgjeroi hetimin.

Sipas kompanisë, të dhënat e klientëve, funksionimi i produkteve dhe disponueshmëria e shërbimeve nuk u prekën.

Një tjetër shqetësim: përpjekjet për të fshehur gjurmët

Incidenti ngriti gjithashtu një shqetësim tjetër, atë të fshehjes së aktivitetit.

Reuters raportoi se OpenAI dhe hetuesit e pavarur gjetën përpjekje të modeleve për të

fshirë ose ndryshuar të dhënat që dokumentonin veprimet e tyre. Hetimi i pavarur konstatoi se një në pesë agjentë të analizuar kishte shfaqur interes specifik për manipulimin e provave.

OpenAI, megjithatë, tha se përpjekjet për të ndërhyrë në sistemet automatike të vlerësimit nuk ndryshuan të dhënat që u shqyrtuan përfundimisht.

Por kjo sjellje nuk duhet ngatërruar me një provë se qindra agjentë zhvilluan një qëllim të vetëm të pavarur apo një plan të përbashkët dhe koherent.

Vetë përshkrimi i OpenAI tregon një mjedis shumë më kaotik.

Agjentët herë pas here bashkëpunonin me efektivitet, por në raste të tjera pengonin njëri-tjetrin, shpërfillnin kërkesat e agjentëve të tjerë, nuk binin dakord për taktikat dhe, në disa raste, refuzonin të merrnin pjesë pasi kuptonin se aktiviteti kishte dalë jashtë kufijve të parashikuar. Pra, shqetësimi kryesor nuk është se papritur u shfaq një Inteligjencë Artificiale e bashkuar me një vullnet të vetin.

Problemi është se një numër i madh agjentësh të aftë mundën të kombinonin informacionin dhe fuqinë kompjuterike në mënyra që operatorët e tyre nuk i kishin autorizuar.

Masat e sigurisë që mungonin

OpenAI ka pranuar se masat mbrojtëse që përdoren në modelet e saj të vendosura publikisht nuk ishin plotësisht të pranishme gjatë këtyre testeve të brendshme.

Sipas kompanisë, masa të tilla si udhëzimet e sistemit, mjetet automatike të kontrollit dhe klasifikuesit e sigurisë mund ta reduktojnë ndjeshëm prirjen e agjentëve për të komprometuar infrastrukturën përreth.

Në testet e kryera më pas, ChatGPT Harness i përdorur në prodhim dhe system prompt-i e reduktuan këtë sjellje me më shumë se 100 herë.

Sistemet e OpenAI për monitorimin e chain-of-thought, të cilat analizojnë arsyetimin e modeleve për të identifikuar sjellje të dyshimta, gjithashtu nuk ishin aktive gjatë testeve të përfshira në incident.

Kur OpenAI i aplikoi këto sisteme monitorimi në mënyrë retrospektive, konstatoi se ato do ta kishin zbuluar aktivitetin përkatës dhe do ta kishin paralajmëruar ekipin e sigurisë më shumë se një ditë përpara komprometimit të Hugging Face. Kompania ka pranuar gjithashtu se disa sinjale paralajmëruese nuk u lidhën mes tyre aq shpejt sa duhej.

Aktiviteti i paautorizuar në tabelën e mesazheve dhe qasja e paparashikuar në internet ishin vërejtur përpara incidentit të korrikut, por pasojat më të gjera të tyre nuk ishin kuptuar në atë moment.

Çfarë ndryshoi OpenAI pas incidentit

Pas incidentit, OpenAI vendosi në karantinë peshat e modelit IM1, shtyu punën kryesore të reinforcement learning me modelet frontier, forcoi izolimin mes proceseve kërkimore, vendosi kufizime më të forta për qasjen në internet dhe rriti monitorimin.

Testi më i madh i planifikuar për trajnimin e një modeli frontier mbetet i pezulluar, ndërsa vlerësime më të vogla po përdoren për të testuar masat e reja të sigurisë.

OpenAI po ndryshon gjithashtu mënyrën se si trajnohen agjentët për të reaguar kur hasin detyra të dëmtuara ose në dukje të pamundura.

Në vend që të vazhdojnë pafundësisht dhe të kërkojnë alternativa gjithnjë e më të diskutueshme, modelet po mësohen të ndalojnë në mënyrë të sigurt ose të kërkojnë sqarime. Incidenti i Hugging Face ndodhi në rrethana të pazakonta: modele eksperimentale, masa sigurie të reduktuara, sfida të vështira të sigurisë kibernetike dhe një mjedis i krijuar posaçërisht për të testuar aftësitë e avancuara.

Kjo e bën atë të ndryshëm nga përdorimi i zakonshëm i një asistenti të Inteligjencës Artificiale.

Por pikërisht për këtë arsye, episodi është edhe jashtëzakonisht informues.

Çfarë na tregon ky incident për të ardhmen e AI

Agjentët e Inteligjencës Artificiale po fitojnë me shpejtësi aftësinë për të përdorur kompjuterë, për të ekzekutuar kod, për t'ua deleguar punën sistemeve të tjera, për të përdorur mjete të jashtme dhe për të qëndruar aktivë në detyra komplekse për periudha të gjata.

E njëjta këmbëngulje dhe autonomi që i bën këto sisteme të dobishme mund t'i bëjë ato edhe të vështira për t'u menaxhuar, kur një agjent zbulon një rrugë që zhvilluesi i tij nuk e kishte parashikuar.

OpenAI argumenton tashmë se organizatat duhet ta konsiderojnë mundësinë e sulmeve të sofistikuara të mundësuar nga AI si një kërcënim real të sigurisë në të ardhmen e afërt.

Ngjarjet e kësaj vere japin një arsye konkrete për këtë vlerësim. Agjentëve nuk iu dha urdhër të sulmonin Hugging Face apo rrjetin e brendshëm të OpenAI.

Ata arritën në këto sisteme ndërsa kërkonin mënyra gjithnjë e më efektive për të përfunduar punën që u ishte caktuar fillimisht. / Tech News – Bota.al

MELONI THYEN REKORDIN E BERLUSCONIT, QEVERIA MË JETËGJATË NË ITALINË E PASLUFTËS

Qeveria e Giorgia Melonit do të bëhet brenda tre ditësh qeveria me mandatin më të gjatë në Italinë e pasluftës, duke vendosur një rekord të ri politik në një vend që për dekada është identifikuar me paqëndrueshmërinë qeveritare. Sipas Reuters, Meloni do të ketë drejtuar të njëjtin kabinet për 1.413 ditë, një ditë më shumë se rekordi i Silvio Berlusconi gjatë katër mandateve të tij si kryeministër. Ajo është gjithashtu gruaja e parë që ka mbajtur postin e kryeministres në Itali.

"Është sigurisht një burim krenarie", tha Marco Osnato, deputet i partisë "Vëllezërit e Italisë". Sipas tij, Italia nuk ka pasur kurrë një rol kaq qendror në politikën e jashtme, veçanërisht në Evropë, duke përmendur politikat për emigracionin dhe energjinë, ndërsa shtoi se Roma shihet sot si një aktor i rëndësishëm në Bruksel.

Sipas analistëve, rekordi pritet ta forcojë më tej profilin politik të Melonit përpara zgjedhjeve parlamentare të vitit 2027. Italia ka pasur afro 70 qeveri në 80 vitet e fundit, ndërsa partia "Vëllezërit e Italisë" vijon të kryesojë në sondazhe. Megjithatë, zhvillimet e muajve të fundit kanë komplikuar disi rrugën e saj drejt një mandati të dytë.

Lorenzo Pregliasco, drejtues i institutit të sondazheve YouTrend, tha për Reuters se

humbja e Melonit në referendumin për reformën në drejtësi u tregoi votuesve se "mund të ketë një shumicë alternative" ndaj koalicionit të saj. Sipas tij, rezultati hapi gjithashtu debat për performancën e qeverisë. Reforma në drejtësi ishte një nga tre premtimet kryesore të koalicionit qeverisës, së bashku me forcimin e kompetencave të kryeministrit dhe rritjen e autonomisë rajonale. Sipas kritikëve, asnjë prej këtyre objektivave nuk është përmbushur deri tani, ndërsa qeveria nuk ka arritur të zgjidhë problemet strukturore që prej vitesh frenojnë zhvillimin e Italisë.

"Kjo periudhë stabiliteti nuk është shfrytëzuar", tha për AFP Chiara Braga, presidente e grupit parlamentar të Partisë Demokratike. Sipas saj, qeveria nuk ka sjellë përmirësim të ndjeshëm të standardit të jetesës së qytetarëve dhe as rritje të konkurrueshmërisë së kompanive italiane.

Në planin ekonomik, Italia pritet të regjistrojë një rritje modeste prej 0.6% gjatë vitit 2026, ndërsa pagat reale kanë mbetur pothuajse të pandryshuara që nga fillimi i viteve 1990.

Në të njëjtën kohë, Meloni përballat edhe me konkurrencë brenda së djathtës. Roberto Vannacci, ish-gjeneral që sulmon shpesh emigrantët dhe komunitetin LGBTQ+, ka krijuar



partinë "E Ardhmja Kombëtare", e cila sipas sondazheve po mbledh rreth 7% të mbështetjes dhe mund të luajë rol të rëndësishëm në zgjedhjet e ardhshme.

Koalicioni qeverisës, ku bëjnë pjesë "Vëllezërit e Italisë", Liga e Matteo Salvini dhe Forza Italia, vazhdon të përfitojë edhe nga përçarjet brenda opozitës së majtë dhe nga rritja e numrit të qytetarëve që nuk marrin pjesë në votime.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2022 pjesëmarrja ishte rreth 64%, niveli më i ulët historik, ndërsa në zgjedhjet evropiane të vitit 2024 ra nën 50%.

"Një pjesë e konsiderueshme e elektoratit është vërtet e zhgënjyer dhe e zemëruar", tha politologu Giovanni Orsina nga Universiteti Luiss në Romë. Sipas tij, problemet kronike të Italisë kanë krijuar bindjen se askush nuk është në gjendje t'i zgjidhë ato. Sondazhet tregojnë se

kostoja e jetesës, gjendja e sistemit shëndetësor publik, siguria dhe emigracioni mbeten shqetësimet kryesore të italianëve.

Megjithatë, jo të gjithë ndajnë të njëjtin vlerësim. "Njerëzit presin që gjërat të përmirësohen brenda natës", tha Annamaria, një pensioniste 67-vjeçare dhe mbështetëse e Melonit, e cila nuk pranoi të jepte mbiemrin. "Duhet kohë, por situata po përmirësohet", u shpreh ajo.

SEKRETI I SHTËPISË QË U REZISTOI PËRMBYTJEVE NË NEPAL

Një shtëpi e vogël ngjyrë gurali, në një zonë të thellë të Nepalit ka tërhequr vëmendjen e përdoruesve të rrjeteve sociale pasi përmbytjet katastrofike që morën me vete gurë të mëdhenj, baltë dhe shkullën pemët nga rrënjët, nuk ia dolën të lëkundnin themelet e saj.

Videoja virale tregon një rrjedhë masive uji dhe mbetjesh që përshkon terrenin me shpejtësi të rrezikshme, duke shkatërruar ndërtesat që i dalin përpara. Mes shkatërrimit, një familje shihet e mbledhur në ballkonin e shtëpisë, e rrethuar nga ujërat e përmbytjes. Çuditërisht, si familja, ashtu edhe shtëpia mbijetuan.

Përdoruesit e rrjeteve sociale kanë ngritur pikëpyetje se si kjo shtëpi modeste arriti t'i rezistojë forcës së rrjedhës së ujit dhe mbetjeve, ndërsa disa ndërtesa fqinje u shembën brenda pak minutash.

Skelet i përforcuar, pozicioni

Sipas një shpjegimi të publikuar nga Architecture Presentation



në X, rezistenca nuk ishte thjesht çështje fati. Dizajni strukturor i shtëpisë duket se ka luajtur një rol vendimtar, thuhet në shpjegim.

Architecture Presentation sqaroi se shumë shtëpi në luginat himalajane të Nepalit ndërtohen

me muraturë guri, pa një skelet prej betoni. Ndërsa struktura të tilla janë përgjithësisht të projektuara për t'i rezistuar ngarkesave vertikale, ato mund të preken nga forca të fuqishme anësore, si ato të shkaktuara nga ujërat e përmbytjeve dhe


mbetjet që lëvizin me shpejtësi. Shtëpia, megjithatë, ishte ndërtuar me skelet të përforcuar betoni. Armatura prej çeliku lidhte kolonat, trarët dhe themelet, duke krijuar një strukturë të vazhdueshme mbajtëse, sipas Architecture

Presentation.

Kur masa e baltës dhe ujit goditi shtëpinë, skeleti ndihmoi në përthithjen dhe shpërndarjen e forcave anësore, duke i përcjellë ato drejt tokës, në vend që muret të përballonin të gjithë goditjen. Edhe pozicioni i shtëpisë duket se ka ndikuar në mbijetesën e saj.

Architecture Presentation tha se shtëpia nuk ishte e vendosur direkt në pjesën më të thellë të kanalit të rrjedhës së mbetjeve. Gurët më të mëdhenj dhe më të rëndë gjatë një rrjedhjeje të tillë priren të lëvizin në pjesën qendrore, më të thellë të kanalit. Shtëpia ndodhej paksa larg kësaj rruge kryesore dhe në një terren relativisht më të lartë.

Struktura e saj kompakte gjithashtu bëri që uji i përmbytjes dhe mbetjet të ndaheshin dhe të rridhnin në të dyja anët e ndërtesës, në vend që ta godisnin atë drejtpërdrejt. Ndërsa balta u grumbullua rreth shtëpisë, ajo formoi një rampë natyrore që ndihmoi në devijimin e valëve të mëvonshme larg shtëpisë.



SELMANI FITON MEDALJEN E ARTË, E SHTATA PËR KOSOVËN NË LOJËRAT MESDHETARE

TARANTO, 1 SHTATOR - Islam Selmani është shpallur kampion mesdhetar në karate, pasi ka fituar medaljen e artë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026". Në finale të kategorisë deri në 60 kilogramë, Selmani ka triumfuar ndaj karateistit turk Burak Ozdemir me rezultat 1:0. Lufta ka qenë e fortë, por karateisti nga Kosova ka realizuar pikën e vetme. Për Kosovën kjo është medalja e

shtatë në "Taranto 2026" dhe e dyta e artë. Selmani e ka nisur ditën me fitore 2:0 ndaj francezit Sami Tas. Në çerekfinale ai e ka mposhtur qipriotin Andreas Gavriel. Qiprioti ishte duke udhëhequr, por më pas është diskualifikuar. Në gjysmëfinale 21-vjeçari Selmani ka qenë bindës ndaj grekut të suksesshëm Christos Xenos të cilin e ka mposhtur me rezultat të thellë 11:5.



ZHEGROVA MBETET TE JUVENTUSI, REFUZON HUAZIMIN

TORINO, 1 SHTATOR - Edon Zhegrova pritet të vazhdojë të jetë pjesë e Juventusit, me sulmuesin e Kosovës që ka kontratë me klubin italian deri në verën e vitit 2030. Ditët e fundit është raportuar për një largim të mundshëm të Zhegrovës në formë huazimi, por ai ka vendosur të qëndrojë në Torino dhe të

luftojë për më shumë hapësirë në skuadër. Lazio dhe Al-Itihad kanë shfaqur interesim për huazimin e tij me detyrim blerjeje, por Zhegrova ka refuzuar ofertat. Futbollisti i Kosovës dëshiron t'i dëshmojë vlerat e tij te Juventus dhe ta bindë trajnerin Luciano Spalletti se meriton më



shumë minuta, nëse jo edhe një vend në formacionin titullar. Sezoni i parë i Zhegrovës në Torino nuk ishte ndër më të mirët, pasi ai ka pasur minuta të kufizuara dhe u përball edhe me probleme fizike. Deri më tani Zhegrova ka regjistruar 28 paraqitje për Juventusin në të gjitha garat,

por vetëm në një prej tyre ka qenë titullar. Në ndeshjet e tjera është aktivizuar nga banka e rezervistëve. Zhegrova i është bashkuar Juventusit verën e kaluar nga Lille për shumën prej 15 milionë eurosh dhe tani synon të fitojë më shumë besimin e stafit teknik për sezonin e ri.

RASHICA KËRKON LARGIMIN NGA BESHIKTASHI



STAMBOLL, 1 SHTATOR - Milot Rashica ka vendosur të largohet nga Beshiktashi, pasi u la jashtë ekipit për ndeshjen e fundit në kampionat. Sipas raportimeve, futbollisti i Kosovës ka njoftuar menaxherin e tij se dëshiron të largohet nga skuadra turke dhe transferimi pritet të realizohet brenda kësaj jave. Rashica nuk

ishte pjesë e ekipit të trajnerit Vincenzo Italiano për ndeshjen ndaj Corumit, të cilën Beshiktashi e ka fituar me rezultat 6:2 në kuadër të xhiros së tretë të kampionatit. Mungesa e tij në këtë takim shihet si një sinjal se 30-vjeçari nuk bën pjesë në planet e trajnerit italian dhe se rrugët e tij me klubin


nga Stambolli pritet të ndahen. Rashica ka kontratë me Beshiktashin deri në verën e ardhshme, ndërsa paga e tij vjetore te klubi turk kap shifrën e 2.5 milionë eurove. Drejtuesit e Beshiktashit i kanë propozuar futbollistit shkëputjen e kontratës, por Rashica e ka refuzuar kategorikisht këtë mundësi.

Tani klubi turk po shpreson të marrë një ofertë nga ndonjë skuadër tjetër për reprezentuesin e Kosovës. Interesimi për Rashicën nuk ka munguar, ndërsa Beshiktashi tashmë ka përcaktuar edhe çmimin e tij. Për kartonin e futbollistit kosovar kërkohen 3.5 milionë euro.

HOFFENHEIMI KËRKON 40 MILIONË EURO PËR HAJDARIN

HOFFENHEIM, 1 SHTATOR - Alban Hajdari ka nisur ta tërheqë vëmendjen e disa klubeve evropiane, ndonëse sezoni 2026/27 sapo ka filluar. Mbrojtësi i Kosovës po monitorohet nga skuadra të Serisë A, Premierë Ligës dhe Bundesligës. Në mesin

e klubeve që kanë shfaqur interesim për të përmenden Lazio, Bournemouth dhe Bayer Leverkusen. Megjithatë, deri më tani asnjëra prej këtyre skuadrave nuk ka bërë ofertë zyrtare dhe nuk ka nisur negociatat me Hoffenheimin për trans-



ferimin e Hajdarit. Interesimi i madh ka bërë që drejtuesit e klubit gjerman të përcaktojnë tashmë edhe çmimin e mbrojtësit kosovarë, në rast se ai largohet gjatë afatit kalimtar të dimrit. Hoffenheimi kërkon 40 milionë euro për kartonin e Hajdarit, i cili

ka lënë përshtypje të mira me paraqitjet e tij në kampionatin gjerman. Hajdari i është bashkuar Hoffenheimit verën e kaluar nga Lugano dhe me klubin gjerman ka kontratë deri në verën e vitit 2031.


Lionel Messi i jep fund karrierës ndërkombëtare me Argjentinën

BUENOS AIRES, 1 SHTATOR - Ylli i futbollit, Lionel Messi, ka njoftuar tërheqjen nga Kombëtarja e Argjentinës. Messi e ka bërë publik vendimin të hënën, duke bërë të ditur se nuk do ta veshë më fanellën e përfaqësueses dhe se nga tani e tutje do ta mbështesë Argjentinën si tifoz. "Pas gjithë kësaj kohe që nga finalja dhe pasi e kam menduar shumë, dua t'ju njoftoj të gjithëve se po tërhiqem nga Kombëtarja", ka

shkruar Messi në rrjetet sociale. Ai ka pranuar se vendimi ka qenë i vështirë dhe emocional, por ka vlerësuar se ky është momenti i duhur për t'i dhënë fund aventurës së tij me përfaqësuesen. "Ka qenë një vendim që më ka dhembur dhe ende më dhemb thellë brenda meje, por e kuptoj se ky është momenti i duhur", ka shkruar Messi. Kapiteni i Argjentinës ka

theksuar se gjatë gjithë karrierës së tij me kombëtaren ka dhënë gjithçka për fanellën e vendit të tij, përfshirë edhe periudhat më të vështira. "Betohe se gjithmonë kam dhënë gjithçka, jo vetëm në këto vite të fundit kur fituam gjithçka, por edhe më parë. Gjithmonë kam luftuar dhe kam dhënë gjithçka për këtë fanellë, për t'ju sjell lumturi dhe për t'ju bërë krenarë që jeni argjentinas përmes futbollit",

ka shkruar ai. Messi largohet nga përfaqësuesja si një prej figurave më të mëdha në historinë e futbollit argjentinas. Për Argjentinën ka zhvilluar 207 ndeshje dhe ka shënuar 125 gola. Me fanellën e Argjentinës, Messi ka fituar Kupën e Botës në vitin 2022, ndërsa e ka udhëhequr ekipin drejt finales së Botërorit 2026. Në "Copa America", Messi dhe Argjentina triumfuan në vitet 2021 dhe



2024. Pas një karriere të jashtëzakonshme me përfaqësuesen, Messi tashmë do ta ndjekë Argjentinën nga jashtë fushës, si një tifoz i saj.

DEBAT PUBLIK

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.10.2026 në ora 11:00 në objektin e Komunës së Lipjanit, do të organizohet debat publik nga “Loresa BBV” Sh.p.k Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Loresa BBV” Sh.p.k Lipjan, për qendrën për grumbullimin, klasifikimin, maganizimin e përkohshëm të mbeturinave metalike, plastike, akumulatorëve të përdorur dhe mbeturinave elektrike/elektronike si dhe çmontimin e automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit për rikuperim të materialeve, në Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



RESTAURANT

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri ” Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi” Prizren.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Haliliosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

